



KORRIK 2020

UDHËZIM MBI KONKURSIN E  
PRAKTIKAVE TË MIRA 2020



## Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje .....	3
2. Objektivat e Konkursit të Praktikave të Mira .....	4
3. Kategoritë tematike të aplikimeve .....	4
4. Procesi i Konkursit të Praktikave të Mira .....	9
5. Rolet dhe Përgjegjësitë Institucionale.....	10
6. Ku dhe si do të dërgohet Aplikimi nga Bashkia .....	11
7. Vlerësimi dhe Përzgjedhja e Praktikës më të Mirë .....	12
8. Aneks .....	17

# Mbështetje për Organizimin e Konkursit të Praktikave të Mira (KPM), edicioni i katërt (2020)

## 1. Hyrje

Përmirësimi i efikasitetit të përgjithshme të strukturave të qeverisjes vendore, forcimi i qeverisjes së mirë në nivel vendor, forcimi i demokracisë vendore nëpërmjet rritjes së instrumenteve të llogaridhënies, transparencës, komunikimit publik, forcimi i financave vendore dhe rritja e autonomisë fiskale, nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel vendor janë objektivat kryesore strategjike të politikës<sup>1</sup> dhe reformës për qeverisjen vendore dhe decentralizim, krahas forcimit të kapaciteteve të administratës vendore.

Koncepti i ‘qeverisjes së mirë’ në nivel vendor tregon cilësi, efektivitet dhe efikasitet të administratës vendore në ofrimin e shërbimeve publike kundrejt standardeve të përcaktuara në ligj, përfshirje të qytetarëve në politikën dhe iniciativat vendore, rritjen e transparencës dhe të cilësisë të vendimmarrjes të organit përfaqësues dhe organit ekzekutiv të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV).

Një balancë e drejtë midis qeverisjes qendrore dhe qeverisjes vendore që aftëson zbatimin e reformave është garancia e vetme për integrimin e suksesshëm të Shqipërisë në strukturat e Bashkimit Evropian<sup>2</sup>.

Konkursi i Praktikave të Mira (KPM) është një instrument që mundëson shkëmbimin e informacionit nga NJVV mbi praktikat të mira dhe iniciativat të zbatuara në fusha të ndryshme të administrimit dhe menaxhimit të funksioneve të qeverisjes vendore dhe qeverisjes së mirë në nivel vendor në kuadër të zbatimit të politikës për vetëqeverisjen vendore /dhe të Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore (SKNQVD).

Është e rëndësishme që të kuptohet se KPM nuk është vetëm një instrument konkurrimi dhe vlerësimi bazuar në një grup kriteresh dhe pikëzimi, por është një mundësi që bashkitë të ofrojnë informacion të rëndësishëm në çështje specifike në nivel vendor, të tilla si praktikat dhe politikat kundrejt reformës së decentralizimit (dhe sektorëve<sup>3</sup> që përkohet me kategoritë e konkurrimit), besueshmëri dhe pjesëmarrje, procese sistematike dhe ndërveprime të vijueshme me qytetarët, politika dhe praktika sensitive ndaj nevojave të grupeve më pak të privilegjuar. KPM është një forum i dobishëm për shkëmbimin e informacionit dhe të njohjes me synimin e përmirësimit të shërbimeve dhe vendimmarrjen e organit përfaqësues.

Historikisht, konkursi i praktikave të mira është organizuar me mbështetje të programit *ddp* (një program i financuar nga SDC) në vitin 2016, 2017 dhe 2018. Bazuar në interesin dhe nivelin e pjesëmarrjes të bashkive, si dhe me mbështetjen e Zëvendësministrit të Brendshëm për qeverisjen vendore, edicioni i tretë u organizua për herë të parë i drejtuar nga AMVV në vitin 2018, që shënoi një hap drejt institucionalizimit të kësaj praktike.

Edicioni i katërt, 2020, i KPM do të drejtohet nga **Ministria e Brendshme** dhe **AMVV**, me mbështetje të *Bashki të Forta* (BtF). BtF është një projekt i Agjencisë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që zbatohet nga Helvetas, në 61 bashkitë e vendit<sup>4</sup>. Synimi kryesor i

<sup>1</sup> Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisjen Vendore

<sup>2</sup> Komunikimi mbi Politikën e Zgjerimit të BE, 2019

<sup>3</sup> Menaxhimi I Mbetjeve, Arsimi Parashkollor dhe Mbrojtja Civile në fushën e shërbimeve dhe Demokracia Vendore dhe Qeverisja (në kategorinë e legjislativit vendor)

<sup>4</sup> Faza e parë e projektit BtF, 2018-2022

projektit BtF është që qytetarët në Shqipëri të përfitojnë në nivel vendor nga bashkitë e orientuara drejt shërbimeve ndaj qytetarëve dhe nga përmirësimi i tyre bazuar në kompetencat dhe funksionet, veçanërisht të lidhur me menaxhimin e mbetjeve, edukimin parashkollor, performancën e bashkive, menaxhimin e mbrojtjes civile dhe forcimin e rolit të këshillave bashkiakë.

## 2. Objektivat e Konkursit të Praktikave të Mira

1. Të njohë dhe vlerësojë praktikën më të mirë të bashkisë në nivel ekzekutiv dhe legjislativ në kategoritë e përzgjedhura të veprimtarisë së Bashkive;
2. Të nxitë inovacionin në fusha të ndryshme;
3. Të inkurajojë ndërveprimin në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar më institucione, aktorë dhe grupe të ndryshme interesi, përfshirë shoqërinë civile dhe sektorin privat;
4. Të ofrojë informacion dhe të dhëna praktike në zbatimin e përpjekjeve reformuese të qeverisjes vendore dhe decentralizimit, zhvillimit të kapaciteteve të administratës vendore nëpërmjet një përjasje nga poshtë-lart dhe në respektim të parimeve dhe koncepteve të qeverisjes së mirë vendore<sup>5</sup>.

## 3. Kategoritë tematike të aplikimeve

Kategoritë tematike<sup>6</sup> për aplikimin e Bashkive në edicionin e katërt të KPM, të vitit 2020, janë si më poshtë vijon:

**Kategoria 1: Shërbimet publike – Administrimi dhe Menaxhimi i Arsimit para-shkollor**

**Kategoria 2: Shërbimet publike – Administrimi dhe Menaxhimi i Mbetjeve**

**Kategoria 3: Administrimi dhe Menaxhimi i Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile**

**Kategoria 4: Aktiviteti përfaqësues dhe mbikëqyrës i Këshillit Bashkiak (KB)**

---

<sup>5</sup> Ligj nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, KiE parime për qeverisjen e mirë në nivel vendor:

-Reforma e decentralizimit kërkon përpjekje të përqendruara në ndërtimin e kapaciteteve dhe reformave institucionale dhe duhet të shoqërohet me forcimin e autoriteteve vendore bazuar në parimin e “subsidiaritetit”.

-Pjesëmarrja nëpërmjet përfshirjes dhe fuqizimit të qytetarëve duhet të jetë parimi themelor në vendimmarrjen, zbatimin dhe ndjekjen dhe monitorimin në nivel vendor.

-Autoritetet vendore duhet të njohin interesat e ndryshme brenda shoqërisë civile dhe sektorit privat dhe duhet të përpiqen që të jenë gjithëpërfshirëse në zhvillimin progresiv të komuniteteve dhe territorit.

-Zbatimi i parimit të mos-diskriminimit për të gjithë partnerët, qeverisjen vendore dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve vendore, rajonale dhe institucioneve të qeverisjes qendrore.

-Informacioni duhet të ruhet, të bëhet publik (ose i vlefshëm) jo vetëm për të rritur efikasitetin e autoriteteve vendore, por për të mundësuar që qytetarët të gëzojnë të drejtat e tyre të plota dhe përfshihen në vendimmarrjen vendore.

-Eficienca dhe efektiviteti në ofrimin e shërbimeve, ngritja dhe zbatimi i sistemeve të performancës që mbulojnë objektivat e zhvillimit, shërbimet dhe funksionet shoqëruar me tregues dhe raporte të rregullt mbi performancën dhe progresin<sup>5</sup>.

-Rritja e funksioneve të transferuara tek qeverisja vendore duhet të shoqërohet me masa për të ndërtuar kapacitete të qëndrueshme për ushtrimin e këtyre funksioneve.

<sup>6</sup> Kategoritë dhe fushat e konkursit mund të shtohen në një bashkëpunim më të zgjeruar me donatorë të tjerë. Institucionet kombëtare inkurajohen që të bashkë-financojnë këtë platformë motivuese për pushtetin vendor pas krijimit të një baze të mirë institucionale të këtij instrumenti konkurrues.

Në mënyrë të detajuar, kategoritë e aplikimeve jepen si vijon:

*Tabela 1. Kategoria “Shërbimet publike – Administrimi dhe Menaxhimi i Arsimit parashkollor”*

<b>Kategoria 1</b>	<b>Shërbimet Publike: Administrimi dhe Menaxhimi i Arsimit Parashkollor (kopshtet)</b>
Fusha të aplikimeve (lista nuk është shteruese)	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Praktika të mira që synojnë përmirësimin e planifikimit dhe monitorimit të shërbimit: vendosjes së standardeve vendore të përballueshme dhe respektimit të standardeve kombëtare,</li> <li>2. Praktika që sigurojnë qëndrueshmëri financiare të shërbimit në kohë, mbulimin e territorit nga shërbime me të njëjtën cilësi ose standard,</li> <li>3. Sistemi i menaxhimit të performancës mundëson dhe zhvillon efikasitetin dhe efektivitetin e shërbimit, por edhe transparencën dhe llogaridhënien ndaj qytetarëve/prindërve,</li> <li>4. Inovacioni – Zgjidhje të reja dhe efikente janë konsideruar për përmirësimin e shërbimit avantazh nëse praktika është bazuar në metoda bashkëkohore për ofrimin e shërbimit (përfshi përdorimin e teknologjisë së informacionit).</li> <li>5. Metoda praktike dhe procedura janë krijuar dhe përdorur me qëllim transformimin e aftësive në kapacitet dhe sigurimin e rezultateve më të mira.</li> <li>6. Përmirësimi i monitorimit të shërbimit; ndërveprimi me aktorë të tjerë, si Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC), komunitetin e biznesit dhe aktorë të tjerë për të gjetur zgjidhje funksionale.</li> <li>7. Ofrimi i informacionit publik dhe transparent i vlefshëm për qytetarët mbi shërbimin, funksionimi i bordeve dhe këshillave të prindërve.</li> <li>8. Bashkëpunimi me sektorin privat ka prodhuar rezultate të vlefshme.</li> <li>9. Bashkitë kanë kryer riorganizime të strukturave të tyre për t’iu përgjigjur këtij funksioni (ende të ri) dhe rritje të kapaciteteve të tyre, të cilat kanë prodhuar rezultatet konkrete në shërbime.</li> <li>10. Te tjera</li> </ol> <p><u>Shënim:</u> Praktika e propozuar në këtë fushë të kategorisë 1 mund t’i korrespondojë një rasti të vetëm ose mund të jetë e shtrirë në të gjithë territorin e Bashkisë.</p>
Çmimet	Për këtë fushë janë planifikuar tre (3) çmime, nga të cilat dy (2) do të vlerësohen nga juria dhe një (1) nga publiku. Çdo çmim është ekuivalent me 5,000 Euro.

Tabela 2. “Shërbimet publike – Administrimi dhe Menaxhimi i Mbetjeve”

Kategoria 2	Shërbimet Publike / Menaxhimi i mbetjeve
Fusha të aplikimeve (lista nuk është shteruese)	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përmirësimi i planifikimit dhe monitorimit të shërbimit që ka prodhuar rezultate konkrete në përmirësimin e tij dhe rritjen e kënaqësisë së qytetarëve.</li> <li>2. Përmirësimi i buxhetimit të shërbimit, kosto-efektivitetit, të ardhura, sigurimi i qëndrueshmërisë financiare të shërbimit në kohë.</li> <li>3. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit në drejtim të plotësimit të standardeve kombëtare dhe aftësimi i bashkive për të vendosur standarde vendore të përballueshme, bazuar në të dhëna të besueshme dhe verifikueshme,</li> <li>4. Përmirësimi i transparencës në ofrimin e shërbimit, sigurimi i aksesit të informacionit nga qytetarët për shërbimin,</li> <li>5. Përmirësimi i monitorimit të shërbimit; ndërveprimi me aktorë të tjerë, si OSHC, komunitetin e biznesit dhe aktorë të tjerë,</li> <li>6. Nxitja e përfshirjes së sektorit privat në ofrimin e shërbimit me rezultat përmirësimin e cilësisë dhe shtrirjes së tij, si dhe respektimit të standardeve mjedisore e infrastrukurore,</li> <li>7. Gjenerimi, mbledhja, përdorimi dhe shpërndarja e të dhënave të verifikueshme falë përdorimit të metodave që sigurojnë besueshmëri të tyre në funksion të efikasitetit dhe transparencës,</li> <li>8. Advokim në bashkëpunim me sektorin privat dhe/ose shoqërinë civile për të nxitur një politikë të vlefshme për komunitetin (p.sh. në aspekte që lidhen me ripërdorimin, riciklimin, ulja e sasisë së mbetjeve),</li> <li>9. Bashkëpunimi me shoqërinë civile, aktorë të edukimit dhe ndërgjegjësimit për të mundësuar nxitjen e bashkëpërgjegjësisë komunitet-qeveri vendore/kombëtare në zbatimin e rregullave për ruajtjen e mjedisit (fokusohu tek mbetjet),</li> <li>10. Inovacioni në përdorimin e teknologjisë apo metodave që përbëjnë risi në adresimin e çështjeve të sektorit/ofrimin të shërbimit (p.sh. ekonomia ricikluese, përfitimi i energjisë, formalizimi i sektorit informal, përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit etj.)</li> </ol> <p><b>Shënim:</b> Praktika e propozuar në këtë fushë të kategorisë 2 mund ti korrespondojë një rasti të vetëm ose mund të jetë e shtrirë në të gjithë territorin e Bashkisë.</p>
Çmimet	Për këtë fushë janë planifikuar tre (3) çmime, nga të cilat dy (2) do të vlerësohen dhe jepen nga juria dhe një (1) nga publiku. Çdo çmim është ekuivalent me 5,000 Euro.

Tabela 3. Administrimi dhe Menaxhimi i Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile

Kategoria 3	Funksioni i Mbrojtjes Civile dhe Emergjencave Civile
Fusha të aplikimeve (lista nuk është shteruese)	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përmirësimi i strukturës dhe kapaciteteve njerëzore dhe mjeteve logjistike në nivel vendor për të siguruar një zbatim efektiv të funksionit për mbrojtjen civile<sup>7</sup>, përfshirë ngritjen e strukturave komunitare dhe grupeve të vullnetarëve,</li> <li>2. Përmirësimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet autoriteteve vendore, rajonale dhe institucioneve qendrore, OSHC, komunitetin e biznesit dhe aktorë të tjerë për të reaguar më mirë ndaj emergjencave civile, marrjes së masave dhe investimeve parandaluese, zbutjen e situatës dhe rimëkëmbjen për familjet dhe individët më të prekur,</li> <li>3. Marrja e masave për të siguruar përputhshmëri me kërkesat e Ligjit për mbrojtjen civile (ligj 45/2019) dhe Ligj 152/2015 “Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”,</li> <li>4. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit në drejtim të plotësimit të standardeve kombëtare,</li> <li>5. Sisteme të dhënash (përfshirë grupe në nevojë) në menaxhimin e suksesshëm të situatave të riskut,</li> <li>6. Menaxhim i suksesshëm i situatave që lidhen me situatën e tërmetit dhe COVID 19, por edhe përmytjeve, zjarreve etj.</li> <li>7. Advokim në bashkëpunim me sektorin privat dhe/ose shoqërinë civile (apo mes bashkive) për të nxitur një politikë të vlefshme për komunitetin në situatë emergjence apo gjendjeje të jashtëzakonshme,</li> <li>8. Modele të qëndrueshme vullnetarizmi apo bashkëpunimit me median dhe aktorë të tjerë kyç në komunitet për tejkalimin e situatave të emergjencave apo gjendjes së jashtëzakonshme,</li> <li>9. Nxjerrje e mësimave nga praktika me menaxhimin e emergjencave apo gjendjes së jashtëzakonshme, të cilat kanë filluar të vihen në jetë duke sjelle ndryshime në struktura, burime, procese dhe ndërveprime.</li> </ol> <p><b>Shënim:</b> Praktika e propozuar në këtë fushë të kategorisë 3 mund ti korrespondojë një rasti të vetëm ose mund të jetë e shtrirë në të gjithë territorin e Bashkisë.</p>
Çmimet	Për këtë fushë janë planifikuar tre (3) çmime, nga të cilat dy (2) do të vlerësohen nga juria dhe një (1) nga publiku. Çdo çmim është ekuivalent me 5,000 Euro.

<sup>7</sup> Struktura për Mbrojtjen Civile përfshin Drejtorinë për Mbrojtjen Civile në Bashki (ose sektorin për MC), policinë bashkiake dhe Shërbimin për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin.

**Tabela 4. Aktiviteti përfaqësues dhe mbikëqyrës i Këshillit Bashkiak (KB)**

Kategoria 4	Aktiviteti përfaqësues dhe mbikëqyrës i Këshillit Bashkiak (KB)
Fusha të aplikimeve (lista nuk është shteruese)	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Praktika që kanë përmirësuar organizimin e brendshëm të KB, komunikimin dhe ndërveprimin me këshillat komunitare,</li> <li>2. Vendimet e KB janë marrë dhe ushtruar në përputhje me rregullat dhe rregulloren e KB, ato dokumentohen dhe bëhen publike,</li> <li>3. Praktika që lidhen me përmirësimin e procedurave të vendimmarrjes: roli i sekretariatit të KB dhe procedurat e përgatitjes së akteve normative (dhe jo vetëm),</li> <li>4. Praktika të mira në hartimin dhe mbikëqyrjen e politikave të zhvillimit vendor, dhe vendosjen e standardeve vendore në shërbime,</li> <li>5. Praktika mbi masa për të parandaluar forma të ndryshme të korrupsionit; zbatimi i Kodit të etikës, konfliktet e interesit deklarohen në kohë për të mos influencuar vendimmarrjen,</li> <li>6. Praktika që lidhen me procesin e konsultimit, nismave qytetare/peticioneve, ankesave-kërkesave të komunitetit në jetën publike, komunitetin e biznesit, pakicave etnike (ka rregulla të qarta të përfshirjes së qytetarëve përfshi grupet në nevojë dhe grupeve të ndryshme të interesit në çështjet publike vendore),</li> <li>7. Praktika që lidhen me monitorimin e KB për shërbimet që ofrohen nga bashkia me qëllim sigurimin e ofrimit të shërbimit në përputhje me kuadrin ligjor dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit kundrejt standardeve kombëtare dhe vendore,</li> <li>8. Praktika që demonstrojnë që këshilli ushtron funksionin e vet përfaqësues dhe mbikëqyrës përmes një plani të mirëmenduar dhe financuar të këshillit,</li> <li>9. Praktik që dëshmojnë inovacion (p.sh. përdorimin e teknologjisë, medias sociale etj.) në ushtrimin e funksionit.</li> </ol>
Çmimet	Për këtë fushë janë planifikuar tre (3) çmime, nga të cilat dy (2) do të vlerësohen dhe jepen nga juria dhe një (1) nëpërmjet votimit të publikut. Çdo çmim është ekuivalent me 5,000 Euro.

**Shënim:**

Bashkia mund të konsiderojë edhe praktika të cilat janë realizuar ose që janë në proces me partnere të tjerë si organizata të shoqërisë civile, organizata komunitare, por Bashkia të ketë pasur rolin kryesor (në rast se praktika është në proces, duhet që progresi të jetë i tillë që të lejojë evidentimin e rezultateve të matshme. Propozime mbi:

- Praktika të zbatuara në bashkëpunim me organizata të SHC, organizata komunitare, komunitetin e biznesit.



- Praktika të zbatuara me anë të një përfaqëse me pjesëmarrje që të përfshijë komunitetin e biznesit, institucione të qeverisë qendrore dhe vendore që veprojnë në nivel rajoni (qarku), institucione të pavarura dhe shtypin.
- Praktika që promovojnë qeverisjen e mirë, transparencën, besueshmërinë, informimin publik.

## 4. Procesi i Konkursit të Praktikave të Mira

Fazat kryesore të cilat identifikohen lidhur me organizimin e KPM:

1. Planifikimi: institucionalizimi (krijimi i grupit të punës), hartimi i kalendarit të aktiviteteve kryesore, identifikimi i fushave prioritare për aplikim nga bashkitë; Përgatitja e “Udhëzimit për Thirrjen e Konkursit të Praktikave të Mira” / dhe formati i aplikimit.
2. Komunikimi / Letër zyrtare për Bashkitë mbi Thirrjen për Konkursin e Praktikave të Mira, edicioni 4 (2020). Letër ftesa për konkursin shoqërohet me “Udhëzimin për KPM”; ngritja e grupeve të vlerësimit për çdo kategori kryesore dhe azhurnimi i faqes së internetit të KPM ankoruar në faqen e AMVV.
3. Organizimi i seancave informuese mbi Konkursin e Praktikave të Mira, komunikim i vijueshëm ndërmjet AMVV dhe bashkive mbi bazën e pyetjeve për sqarim, krijimi i grupeve të vlerësimit.
4. Organizimi i eventeve dhe ndarja e çmimeve.
5. Ndjekja pas përfundimit të KPM dhe raportimi.

Tabela 5. Kalendarit i KPM 2020 (edicioni i katërt)

Fazat kryesore	Aktivitete	Afati <sup>8</sup>	Kush është përgjegjës
1. Planifikimi dhe institucionalizimi	Hartimi i kalendarit të KPM dhe udhëzuesi  Krijimi i platformës online	15 Qershor-14 Korrik 2020	MB / AMVV / BtF
2. Lancimi	Këshilli Konsultativ  Ftesa dhe udhëzuesi dërgohet në të gjitha Bashkitë dhe Ministrinë e përfshira (përfshirë aktorët e shoqërisë civile <sup>9</sup> dhe bota akademike)	14-16 Korrik 2020	MB/AMVV / BtF
3. Informimi dhe komunikimi	Organizimi i 4 takimeve informuese online (4 rajone) sipas kategorive të konkursit, dhe komunikim në vijueshmëri me bashkitë në përgjigje të pyetjeve për sqarim.	20 Korrik – 10 Gusht 2020	AMVV  Kordinatorët e BtF
4. Dorëzimi i praktikave të mira nga bashkitë	Dorëzimi i aplikimeve nga Bashkitë së bashku me prezantimet në PPT dhe video ilustruese tek AMVV.	<b>30 Shtator 2020</b>	AMVV / BtF

<sup>8</sup> Data janë indikative dhe do të përditësohen në faqen e internetit të AMVV

<sup>9</sup> Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile do të identifikohen në bashkëpunim me projektin “Lëviz Albania”

	Koordinatorët e BtF asistojnë bashkitë në terren		
5. Procesimi i praktikave	Aktivitetet të administrimit të procesit, Përgatitja e katalogut dhe procesit të votimit online Promovimi për publikun i KPM Ngritja dhe trajnimi i jurive. Votim online nga publiku	Tetor 2020	AMVV / MB Lehtësuar nga BtF 4 Koordinatorë të BtF në qytet ku do vendoset të mbahen eventet
5. Eventi i KPM (edicioni katërt)	Organizimi i eventeve kombëtare të KPM	Nëntor 2020	AMVV / MB / BtF Lehtësuar nga BtF
6. Ndjekja e rezultateve	Sigurimi i ndjekjes / vijueshmërisë transparencë e procesit të konkursit dhe procesit të vlerësimit, përgatitje e një raporti përmbyllës mbi KPM.	Dhjetor 2020	AMVV / MB

## 5. Rolet dhe Përgjegjësitë Institucionale

Institucionet kryesore përgjegjëse për organizimin e KPM (edicioni 4, 2020) janë: 1) Ministria e Brendshme, AMVV, lehtësuar nga projekti BtF. Institucione të tjera qendrore, si Ministrinë e Linjës, institucioni i Prefektit, parlamenti, universitetet, shoqatat e qeverisjes vendore/ sektori privat, projekte zhvillimi/donatorë dhe OSHC do të marrin pjesë për vlerësimin e praktikave të mira në eventet kombëtare. KPM 2020 do të organizohet nën drejtimin e Zëvendësministrit të Brendshëm për pushtetin vendor. Si më poshtë përgjegjësitë:

- **Ministria e Brendshme:** MB adreson zyrtarisht Ministrinë e Linjave dhe institucionet e tjera për ngritjen e jurive.
- **AMVV** është institucioni përgjegjës për administrimin e të gjithë procesit të konkursit të praktikave të mira sa i takon pushtetin vendor, që përfshin shpalljen e konkursit, zbatimin dhe monitorimin dhe informimin periodik në Ministrinë e Brendshme dhe BtF, administrimin e ankesave nga bashkitë (nëse do të ketë). Ajo është përgjegjëse për të koordinuar punën me ekspertin e BtF për hartimin e raportit mbi mbarëvajtjen e konkursit dhe ndërveprimin me koordinatorët e BtF në terren për të lehtësuar procesin. Me përfundimin e KPM 2020, AMVV siguron ndjekjen / vijueshmërinë e detyrave, si: (i) transparencën e procesit të konkursit dhe procesit të vlerësimit, (ii) përgatitjen e një raporti përmbyllës mbi procesin/ pjesëmarrjen e bashkive, praktikave dhe eventin, dhe (iii) ruan dhe mirëmban bazën e të dhënave të konkursit, mirëmbajtjen e faqes së internetit të KPM.

- **BtF, Helvetas**<sup>10</sup> mbështet institucionet shqiptare për mundësimin e organizimit të KPM 2020 (edicioni 4).

## 6. Ku dhe si do të dërgohet Aplikimi nga Bashkia

### 6.1 Aplikimi nga Bashkitë

Aplikimi duhet të shoqërohet me një letër zyrtare të nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë dhe vulosur. Letra zyrtare e skanuar dërgohet bashkë me aplikimin. Aplikimi do të dërgohet me postë elektronike në adresën e AMVV ([amvv@mb.gov.al](mailto:amvv@mb.gov.al)).

Gjithashtu, bashkitë konkurese duhet të aplikojnë online në faqen e internetit si më poshtë: <https://praktikatemira.qeverisjvendore.gov.al/>

Aplikimi përbëhet nga tre module:

1. Formati i aplikimit (shiko Aneks 1 – Forma e Aplikimit).
2. Prezantim në Power Point (PPT), jo më shumë se 10 faqe prezantimi.
3. Video (jo më shumë se 5 minuta)

### 6.2 Afati për dorëzimin e aplikimit nga Bashkia

Afati për dorëzimin e aplikimit nga Bashkia është **30 Shtator 2020, ora 16.00**. Bashkitë inkurajohen që të dërgojnë praktikat përpara afatit dhe jo të presin ditën e fundit. Aplikimet e dërguara mbas afatit të përcaktuar nuk do të pranohen.

### 6.3 Sesionet e informimit dhe pyetje sqaruese

Sesionet e informimit për KPM 2020 planifikohen të organizohen në periudhën Korrik-Gusht 2020. Informacion i saktë për vendin (ose formën e organizimit) dhe datat e sesioneve të informimit do të njoftohen në platformën e KPM dhe faqen e AMVV (lutemi shikoni linkun më poshtë).

<https://praktikatemira.qeverisjvendore.gov.al/>

Pyetjet për sqarim mbi aplikimin, udhëzuesin dhe pyetje të natyrës institucionale mbi çështje të KPM adresohen në AMVV. Bashkitë mund t'i adresohen për pyetje sqaruese edhe koordinаторit të BtF në Qarkun respektiv për çështje lidhur me hartimin e aplikimit për praktikën e mire dhe mbi përdorimin e platformës.

Pyetje mund të dërgohen jo më vonë se 10 ditë nga afati për dorëzimin e aplikimit në adresën: [AMVV@mb.gov.al](mailto:AMVV@mb.gov.al).

---

<sup>10</sup> Projekt i financuar nga SDC

## 7. Vlerësimi dhe Përzgjedhja e Praktikës më të Mirë

Të gjitha aplikimet do të vlerësohen në përputhje me hapat dhe kriteret e vlerësimit të paraqitura në këtë seksionin. Aplikimet duhet të përgatiten nga Bashkitë sipas udhëzimeve të dhëna në formën e aplikimit që është pjesë e Udhëzuesit mbi KPM 2020, i cili përmban informacion mbi procesin e KPM, formatin e aplikimit, si dhe informacion mbi kriteret e vlerësimit dhe peshën specifike (pikët) mbi bazën e të cilave do të kryhet vlerësimi i aplikimeve. Renditja do të behet sipas pikëve të marra për çdo praktikë bazuar në kriteret e vlerësimit për çdo kategori.

Praktikat do të vlerësohen nga juri profesionale (grup vlerësimi) të përbërë nga specialistë të ministrive, universitetet, shoqatat për qeverisjes vendore, OSHC/ sektori privat, media. Juritë profesionale do të krijohen për çdo kategori të KPM 2020, si më poshtë përshkruar.

Në përfundim të konkursit përzgjidhen praktikat më të mira të renditura sipas pikëve të marra, ku janë planifikuar tre çmime për kategori. Në total, për kategoritë 1, 2, 3 dhe 4, do të shpërndahen 12 çmime.

### 7.1 Përbërja e jurive

Juritë do të përbëhen nga anëtarë të administratës qendrore (Ministritë e linjës, institucioni i Prefektit, institucione të tjera qendrore), universitete dhe OSHC/ sektori privat, shoqata për qeverisjen vendore, media. Në caktimin e përfaqësuesve të jurive nga institucione të ndryshme do të mbahen në konsideratë elementët kryesore të mëposhtëm:

- i. Përbërja e anëtarëve do të jetë e balancuar ndërmjet institucioneve të nivelit qendror dhe institucioneve të tjera të pavarura.
- ii. Përfaqësuesit e nominuar nga institucionet qendrore janë nëpunës me njohuri dhe eksperiencë të spikatur në sektorin / kategorinë e konkursit të praktikave që do të vlerësojnë. Roli i tyre në juri është ai i ekspertit me integritet dhe legjitimitet. Një bio e tij bëhet publike ne faqen e internetit të konkursit.
- iii. Në rast të ndonjë konflikti interesi, Ministria e Brendshme/AMVV lehtëson procesin e shmangies / eliminimit të situatës të konfliktit të interesit.

#### **Për kategorinë 1: Shërbime – Administrimi dhe Menaxhimi i Arsimit Parashkollor (kopshtet)**

Përbërja e jurisë do të jetë nga Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, Shoqata për Autonomi Vendore, Universitetet, shoqëria civile/ sektori privat dhe media.

#### **Për kategorinë 2: Shërbime – Administrimi dhe Menaxhimi i Mbetjeve Urbane**

Përbërja e jurisë do të jetë nga Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, Universitetet, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, shoqëria civile/ sektori privat dhe media.

#### **Për kategorinë 3: Administrimi dhe Menaxhimi i Funkcionit (Shërbimit) të Mbrojtjes Civile**

Përbërja e jurisë do të jetë nga Ministria e Mbrojtjes, institucioni i Prefektit, Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Civile, Universitetet, Shoqata për Autonomi Vendore, shoqëria civile.

## Për kategorinë 4: Aktiviteti legjislativ i organit përfaqësues (Këshillit Bashkiak)

Përbërja e jurisë do të jetë nga Parlamenti, Universitetet, Shoqata e Qarqeve, Aleanca Kombëtare e Grave dhe Vajzave Këshilltare, shoqëria civile/ sektori privat, media.

### 7.2 Hapat e Vlerësimit të Praktikave

#### Hapi 1: Hapja & Kontrolli Administrativ i Praktikës

Gjatë hapjes dhe kontrollit administrativ do të vlerësohen elementët kryesorë si më poshtë<sup>11</sup>:

- Nëse afati është respektuar;
- Nëse praktika është e nënshkruar nga Kryetari/ose Kryetari KB për praktikën e kategorisë 4 dhe e vëlosur;
- Nëse është plotësuar në përputhje me udhëzimet mbi formatin e aplikimit (shiko Aneksin 1).

#### Hapi 2: Vlerësimi bazuar në kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit ndihmojnë për vlerësimin e cilësisë së praktikës kundrejt objektivave dhe prioritetëve të KPM dhe të paraqitur në këtë udhëzim. Disa kriteret e vlerësimit janë ndarë në disa nënkritere. Secilit kriter/ ose nën-kriter do t'i jepen pikë, sipas niveleve:

1 – shumë dobët; 2 – dobët; 3 – mjaftueshëm; 4 - mirë; 5 – shumë mirë.

### 7.3 Kriteret e vlerësimit

#### Kriteret për Kategorinë 1: Administrimi dhe menaxhimi i Arsimit para-shkollor

Nivelet e vlerësimit: 1 – shumë dobët; 2 – dobët; 3 – mjaftueshëm; 4 - mirë; 5 – shumë mirë

Kritere Vlerësimi	Pikët
1. Praktika buron nga një sistem i rregullt monitorimi (me pjesëmarrjen e ekspertëve të shërbimeve të bashkisë, shoqërisë civile, komunitetit të biznesit, institucioneve qendrore/rajonale, komisionit përgjegjës të këshillit, aktorë të tjerë)	5*3
2. Praktika demonstroi parimet e qeverisjes së mirë: efikasitet dhe efektivitet, përfshirje e qytetarëve dhe komuniteteve në nevojë, transparenca dhe llogaridhënia e realizuar.	5*3
3. Praktika respekton kërkesat ligjore (kontribuon të paktën në një standard kombëtar sipas legjislativitetit përkatës dhe në varësi të kategorive të konkurrencës).	5*4

<sup>11</sup> Në rast se praktika e dorëzuar nga bashkia ka shmangie të vogla nga formati i aplikimit, AMVV komunikon me bashkinë duke i lejuar 2 ditë kohë për rishikimin dhe plotësimin e aplikimit sipas udhëzimeve dhe formatit të miratuar. Kjo është e mundur vetëm nëse bashkia e dorëzon praktikën përpara afatit përfundimtar, prandaj inkurajohet dorëzimi i hershëm.

4. Praktika është inovative (me inovacion kuptojmë një risi që përfshin përdorimin e teknologjisë të informacionit, por jo vetëm)	5*3
5. Praktika është e qëndrueshme (financiarisht, burime njerëzore, aftësia për përsëritje të qëndrueshme në kohë, por jo vetëm)	5*3
6. Praktika ka potencial për replikim nga bashki të tjera	5*2
7. Prezantimi	5*2
<b>Totali i pikëve</b>	<b>100</b>

### **Kriteret e vlerësimit për Kategorinë 2: Administrimi dhe Menaxhimi i Mbetjeve Urbane**

Nivelet e vlerësimit: 1– shumë dobët; 2 – dobët; 3 – mjaftueshëm; 4 - mirë; 5 – shumë mire

<b>Kritere Vlerësimi</b>	<b>Pikët</b>
1. Praktika buron nga një sistem i rregullt monitorimi (me pjesëmarrjen e shërbimeve të bashkisë, shoqërisë civile, komunitetit të biznesit, institucioneve qendrore, aktorë të tjerë)	5*2
2. Praktika demonstroi parimet e qeverisjes së mire: efikasitet dhe efektivitet, përfshirje e qytetarëve dhe komuniteteve në nevojë, transparenca dhe llogaridhënia e realizuar.	5*4
3. Praktika kontribuon të paktën në një standard kombëtar sipas legjislacionit përkatës.	5*4
4. Praktika është inovative (me inovacion kuptojmë një risi që përfshin përdorimin e teknologjisë të informacionit, por jo vetëm).	5*2
5. Praktika është e qëndrueshme (financiarisht, burime njerëzore, aftësia për përsëritje të qëndrueshme në kohë, por jo vetëm)	5*4
6. Praktika ka potencial për replikim nga bashki të tjera	5*2
7. Prezantimi	5*2
<b>Totali i pikëve</b>	<b>100</b>

### **Kriteret e vlerësimit për Kategorinë 3: Administrimi dhe Menaxhimi për Mbrojtjen Civile**

Nivelet e vlerësimit: 1– shumë dobët; 2 – dobët; 3 – mjaftueshëm; 4 - mirë; 5 – shumë mire

Kritere Vlerësimi	Pikët
1. Praktika buron nga një sistem i rregullt monitorimi (me pjesëmarrjen e stafit profesional të bashkisë, KB, institucioneve qendrore përfshirë institucionin e Prefektit, dhe aktorë të tjerë).	5*2
2. Praktika demonstroi parimet e qeverisjes së mirë (përfshirja e strukturave komunitare, komunitetit të biznesit, qytetarëve dhe femrave në procese konsultimi, është respektuar transparenca dhe llogaridhënia).	5*2
3. Praktika respekton të paktën një kërkesë ligjore të Ligjit 45/2019 për mbrojtjen civile, ose ligjit 152/2015 për SHMZSH.	5*4
4. Praktika është inovative (me inovacion kuptojmë një risi që përfshin përdorimin e teknologjisë të informacionit, por jo vetëm).	5*3
5. Praktika është e qëndrueshme (financiarisht, burime njerëzore, por jo vetëm)	5*4
6. Praktika ka potencial për replikim nga bashki të tjera	5*3
7. Prezantimi	5*2
<b>Totali i pikëve</b>	<b>100</b>

#### **Kriteret e vlerësimit për Kategorinë 4: Aktiviteti legjislativ i organit përfaqësues të Bashkisë (Këshilli Bashkiak)**

Nivelet e vlerësimit: 1 – shumë dobët; 2 – dobët; 3 – mjaftueshëm; 4 - mirë; 5 – shumë mirë

Kritere Vlerësimi	Pikët
1. Praktika buron nga një sistem i rregullt monitorimi (me pjesëmarrjen e shoqërisë civile, pushtetit vendor, institucioneve qendrore, aktorë të tjerë)	5*3
2. Praktika demonstroi parimet e qeverisjes së mirë (përfshirja e qytetarëve, përfshirje e komuniteteve në nevojë, respektuar transparenca dhe llogaridhënia).	5*3
3. Praktika është rezultat i një funksioni vendimmarrës / mbikëqyrës i cili ka respektuar kërkesat ligjore të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore dhe Ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. KB në vendimmarrjen e tij konsideron dhe respekton standardet kombëtare të politikave kur janë të vlefshme.	5*3

4. Praktika është inovative (me inovacion kuptojmë një risi që përfshin përdorimin e teknologjisë të informacionit, por jo vetëm.	5*3
5. Praktika është e qëndrueshme (financiarisht, burime njerëzore, por jo vetëm)	5*3
6. Praktika ka potencial për replikim nga bashki të tjera	5*3
7. Prezantimi	5*2
<b>Totali i pikëve</b>	<b>100</b>

## 7.4 Dukshmëria

Në aplikimet e tyre, Bashkitë duhet të respektojnë rregullat e dukshmërisë të Ministrisë së Brendshme, AMVV dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe për këtë praktika duhet të përmbajë dukshëm element të tillë, si logo e MB, AMVV dhe BtF/Helvetas/SDC.

Logot duhet të vendosen si më poshtë: Emblema e MB dhe AMVV në këndin e majtë dhe BtF, Helvetas dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në këndin e djathtë.



## 7.5 Numri i aplikimeve

Numri i aplikimeve nuk është i kufizuar. Bashkitë mund të përgatitin dhe dorëzojnë deri **4 aplikime** gjithsej, një për çdo kategori.

## 7.6 Aplikimet e Bashkisë

Për çdo aplikim, bashkia duhet të përgatitë dhe të dorëzojë në formatin elektronik në:

- <https://praktikatemira.qeverisjavendore.gov.al/>
- [AMVV@mb.gov.al](mailto:AMVV@mb.gov.al)

- 1) **Praktikën** (dokument në word) sipas formatit (aneksi 1), e cila dërgohet online në AMVV dhe shoqërohet me letër zyrtare të Bashkisë me logon, firmosur dhe vulosur nga Kryetari i Bashkisë. Për praktikat e kategorisë 4, letra zyrtare shoqëruese e praktikës duhet të nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak. Letra shoqëruese e



praktikës e firmosur nga Kryetari i Bashkisë / ose Kryetari i Këshillit Bashkiak<sup>12</sup> dërgohet online (me email) e skanuar, bashkë me praktikën, brenda datës 30 Shtator 2020.

- 2) **Prezantimin në powerpoint** (PPT) mbi praktikën e mirë duke përdorur maksimumi **600 fjalë**, madhësia e germave duhet të jetë jo më pak se **20pt**, dhe jo më shumë se **10 faqe/slide PPT**, brenda datës 30 Shtator 2020.
- 3) **Video ilustruese** është një instrument i rëndësishëm për votimin e publikut dhe jurinë nëse eventit final do të realizohet online. Video duhet të jetë e gjatë **jo më shumë se 5 minuta**, e filmuar në formatin landscape, të ketë audio dhe tekst lehtësisht të kuptueshëm dhe të dërgohet brenda datës 30 Shtator 2020 bashkë me praktikën dhe prezantimin.

## 7.7 Ankesat

Bashkitë mund të adresojnë një ankesë për një çështje specifike lidhur me KPM 2020 tek AMVV që është institucioni që trajton ankesën dhe kthen përgjigje sqaruese brenda një afati 5 ditor.

<http://praktikatemira.qeverisjavendore.gov.al/ankesa/>

## 8. Aneks

**Aneks 1:** Forma e Aplikimit

<http://praktikatemira.qeverisjavendore.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/formulari.docx>

**Aneks 2:** Tabelat e Kriteve të Vlerësimit

### Kriteret për Kategorinë 1: Administrimi dhe menaxhimi i Arsimit para-shkollor

Nivelet e vlerësimit: 1 – shumë dobët; 2 – dobët; 3 – mjaftueshëm; 4 - mirë; 5 – shumë mire

Kritere Vlerësimi	Shtjellimi Sektorial	Pikët
1. Praktika buron nga një sistem i rregullt monitorimi (me pjesëmarrjen e ekspertëve të shërbimeve të bashkisë, shoqërisë civile, komunitetit të biznesit, institucioneve qendrore/rajonale, komisionit përgjegjës të këshillit, aktorë të tjerë)	Praktika buron nga një dokument strategjik i bashkisë me fokus arsimin parashkollor (AP). Praktika demonstroi bashkëpunim institucional me institucionet qendrore të përfshira në ofrimin e shërbimit për AP. Informacioni mbi performancën e shërbimit mblidhen rregullisht dhe rishikohet më qëllim eliminimit të diferencave ndërmjet çfarë pritej dhe çfarë është arritur.	5*3

<sup>12</sup> Për rastin e praktikave të kategorisë 4

	<p>Rezultatet e monitorimit ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimit, dhe të treguesve të shërbimit dhe kostos, përmirësimin e komunikimit/reagimit të shërbimeve të bashkisë, p.sh. për përmirësimin e infrastrukturës të institucioneve të AP kundrejt nevojave të identifikuara e të planifikuara.</p>	
<p>2. Praktika demonstroi parimet e qeverisjes së mirë: efikasitet dhe efektivitet, përfshirje e qytetarëve dhe komuniteteve në nevojë, transparencë dhe llogaridhënia e realizuar.</p>	<p><i>Efektiviteti:</i> rezultatet përputhen me objektivat e synuara, përdorimi më i mirë i mundshëm e burimeve të vlefshme, sistemi i menaxhimit të performancës mundëson përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimit dhe demonstroi shkallën në të cilën ndërhyrja ka qenë e suksesshme (është arritur rezultati kundrejt objektivave, burimeve njerëzore, kostove, në afatet kohore).</p> <p>Praktika demonstroi që shërbimi i AP ofrohet me të njëjtën cilësi në të gjithë territorin, është siguruar regjistrimi/ndjekja e kopshtit në përqindjen me të lartë të fëmijëve të grup-moshës përkatëse.</p> <p><i>Përfshirja publike:</i> Bashkia ka siguruar që opinionet, shqetësimet e prindërve të reflektohen në planin vendor/ose dokumentin strategjik të bashkisë.</p> <p><i>Përfshirja sociale:</i> Praktika demonstroi që bashkia ka marrë masa për mundësimin e aksesit për grupet vulnerabël, si komunitetet Romë dhe Egjiptiane, fëmijët me AK, fëmijët e rrugës, fëmijët nga shtresat që jetojnë në nivelin e varfërisë.</p> <p><i>Transparencë &amp; llogaridhënie:</i> Praktika demonstroi që bashkia ka instrumente që lejojnë dhe krijojnë mundësi që publiku të njohë planet e bashkisë për AP, fondet në dispozicion, si janë përdorur fondet.</p> <p>Bashkia realizoi <i>audite të shërbimit</i> për monitorim të thelluar të shërbimit, uljen e kostove dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit.</p>	<p>5*3</p>
<p>3. Praktika kontribuon të paktën në një standard kombëtar sipas legjislacionit përkatës.</p>	<p>Numri maksimal i standardeve baze të plotësuara nga bashkia:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Raporti i fëmijëve për grup në arsimin parashkollor (Vendimi nr. 30, datë 12.09.2018).</li> <li>2. Raporti psikolog - Fëmijë dhe Raporti punonjës social - fëmijë në arsimin parashkollor.</li> <li>3. Sipërfaqja e brendshme e kopshtit.</li> <li>4. Menyja e përcaktuar për kopshtet me ushqim .</li> <li>5. Njësia për mbrojtjen e fëmijëve e ngritur në bashki.</li> <li>6. Trajnimet të vijueshme për mësuesit në arsimin parashkollor.</li> </ol>	<p>5*4</p>

	<p>7. Lehtësi për të siguruar aksesin në infrastrukturën e AP për fëmijët me aftësi të kufizuara (rampat dhe banjat).</p> <p>8. Bordi i Kopshtit dhe Këshilli i Prindërve funksional.</p> <p>9. Përdorimi i Portalit “Mësues për Shqipërinë” për përzgjedhjen e mësuesve të Arsimit Parashkollor nga bashkitë.</p> <p>10. Mësues Ndhmës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara.</p> <p>Lista është referuese</p>	
<p>4. Praktika është inovative (me inovacion kuptojmë një risi që përfshin përdorimin e teknologjisë të informacionit, por jo vetëm)</p>	<p>Përdorimi i mjeteve / gjetjeve inovative për ofrimin më të mirë të shërbimit, rritjen e ndërgjegjësimit të popullsisë dhe edukimin e brezit të ri që në shkollë.</p> <p>Bashkia ndërmerr veprime për të identifikuar dhe zbatuar praktika të mira dhe zgjidhje të reja<sup>13</sup>.</p> <p>Praktika ka demonstruar risi në përfshirjen e një numri me të larte të fëmijëve në kopsht krahasuar me numrin total të fëmijëve të territorit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Vendosjen e standardeve lokale për një nënshërbim që lidhet me AP; p.sh.: Vendosja e standardit Nr. fëmijësh për një psikolog/punonjës social.</li> <li>- Përfshirjen e fëmijëve nga grupet vulnerabël.</li> <li>- Bashkëpunimin me biznesin lokal për përmirësimin e shërbimit.</li> </ul> <p>-Bazë të dhënash që lejon njohjen e fëmijëve të moshës përkatëse në territorin e bashkisë dhe kushteve social-ekonomike të tyre.</p> <p>-Bashkia është aktivisht e përfshirë në shfrytëzimin e teknologjisë së informacionit dhe digjitalizimin e proceseve.</p>	5*3
<p>5. Praktika është e qëndrueshme (financiarisht, burime njerëzore, aftësia për përsëritje të qëndrueshme në kohë, por jo vetëm)</p>	<p>Bashkia ka një përjasje të strukturuar për zhvillimin afat-gjatë të praktikës. Ka kujdes nga Kryetari dhe KB për të siguruar qëndrueshmëri dhe zhvillim të integruar e të qëndrueshëm demonstruar në planin e zhvillimit vendor, planin e veprimit lokal me synime të qarta (target).</p> <p>Praktika është e parashikuar në planet e bashkisë dhe mbulohet nga buxheti. Aktorët e përfshirë njohin rolin e tyre dhe janë në gjendje ta përsërisin praktikën në përputhje me rregulloret dhe procedurat e bashkisë.</p>	5*3
<p>6. Praktika ka potencial për replikim nga bashki të tjera</p>	<p>Praktika ka potencial për t'u replikuar/riprodhuar/ose përshtatur në kontekst tjetër, “mësime të transferueshme” bazuar në kushtet sociale, ekonomike specifike ose të ngjashme.</p>	5*2

<sup>13</sup> Parimet e qeverisjes së mirë të KiE

7. Prezantimi	Shkrimi i praktikës në mënyrë të kuptueshme (dhe me informacion të mjaftueshëm për jurinë), vizualizimi dhe kuptueshmëria e PPT/Video, prezantimi i përmbahet kohës.	5*2
<b>Totali i pikëve</b>		<b>100</b>

## Kriteret e vlerësimit për Kategorinë 2: Administrimi dhe Menaxhimi i Mbetjeve Urbane

Nivelet e vlerësimit: 1 – shumë dobët; 2 – dobët; 3 – mjaftueshëm; 4 - mirë; 5 – shumë mire

Kritere Vlerësimi	Shtjellimi Sektorial	Pikët
1. Praktika buron nga një sistem i rregullt monitorimi (me pjesëmarrjen e shërbimeve të bashkisë, shoqërisë civile, komunitetit të biznesit, institucioneve qendrore, aktorë të tjerë)	<p>Praktika demonstroi përparim në zbatimin e objektivave të vendosura në dokumentin strategjik të zhvillimit vendor / ose e lidhur me zbatimin e planit lokal të menaxhimit të mbetjeve; bazuar në një metodologji të njohur për monitorimin e shërbimit.</p> <p>Informacioni mbi performancën e shërbimit mbledhet rregullisht dhe rishikohet më qëllim eliminimit të diferencave ndërmjet çfarë pritej dhe çfarë është arritur. Rezultatet e monitorimit ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimit, dhe të treguesve të shërbimit dhe kostos, përmirësimin e komunikimit/reagimit të shërbimeve të bashkisë, p.sh. për ndryshimin e formës së grumbullimit të mbetjeve (dere me dere, me qese të parapaguara, grumbullim i diferencuar për bizneset, dhe forma të tjera).</p>	5*2
2. Praktika demonstroi parimet e qeverisjes së mire: efikasitet dhe efektivitet, përfshirje e qytetarëve dhe komuniteteve në nevojë, transparenca dhe llogaridhënia e realizuar.	<p><i>Efektiviteti:</i> rezultatet përputhen me objektivat e synuara, përdorimi më i mirë i mundshëm e burimeve të vlefshme, sistemi i menaxhimit të performancës mundëson përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimit dhe demonstroi shkallën në të cilën ndërhyrja ka qenë e suksesshme (është arritur rezultati kundrejt objektivave, burimeve njerëzore, kostove, në afatet kohore).</p> <p>Praktika ka marrë parasysh nevojat e popullsisë dhe komuniteteve në nevojë kur janë shpërndarë burimet dhe shërbimet, ka identifikuar dhe synuar uljen e pabarazive: p.sh. ka ofruar lehtësi të ofrimit të shërbimit / ose për realizimin e pagesave për segmente të caktuara të popullsisë (shtresa të marginalizuara).</p> <p><i>Pjesëmarrja qytetare</i></p> <p>Vlerësohet përfshirja e qytetarëve dhe palëve të interesuara gjatë gjithë ciklit të planifikimit të procesit (që prezantohet nga praktika e mirë), bashkëpunimi ndërmjet sektorëve dhe aktoreve të ndryshëm, përfshirë komunitetin e biznesit.</p> <p><i>Transparenca dhe llogaridhënie:</i></p>	5*4

	<p>Praktika tregon vëmendje dhe përgjegjshmëri nga ana e organeve vendimmarrëse (Kryetari dhe këshilli i bashkisë) mbi kontrollin dhe ofrimin e transparencës mbi administrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve publike, informacionin mbi rezultatet aktuale të shërbimit.</p> <p>Bashkia realizon <i>audite të shërbimit</i> për monitorim të thelluar të shërbimit, uljen e kostove dhe rritjen e efencës dhe efektivitetit të shërbimit.</p>	
3. Praktika kontribuon të paktën në një standard kombëtar sipas legjislacionit përkatës.	<p><i>Mbulimi cilësor</i> me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve në të gjithë territorin dhe popullatën. <i>Ndarja në burim</i> të materialeve të riciklueshme</p> <p>Trajtimi i mbetjeve (futja e teknologjive të trajtimit paraprak)</p> <p>Mbyllja e vend-depozitimeve të paautorizuara</p> <p>Sigurimi i distancës deri në vend-depozitim të autorizuar sipas legjislacionit.</p>	5*4
4. Praktika është inovative (me inovacion kuptojmë një risi që përfshin përdorimin e teknologjisë të informacionit, por jo vetëm).	<p>Përdorimi i mjeteve / gjetjeve inovative për ofrimin më të mirë të shërbimit, rritjen e ndërgjegjësimit të popullsisë dhe edukimin e brezit të ri që në shkollë.</p> <p>Bashkia ndërmer veprime për të identifikuar dhe zbatuar praktika të mira dhe zgjidhje të reja<sup>14</sup>.</p> <p>Praktika vlerëson shkallen e inovacionit si instrument për të adresuar një nevojë/ ose kërkesë akoma të paartikulluar, qoftë në dizejnimin dhe planifikimin e ndërhyrjes, ashtu dhe në zbatimin e saj.</p> <p>Bashkia është aktivisht e përfshirë në shfrytëzimin e teknologjisë së informacionit dhe digjitalizimin e proceseve.</p>	5*2
5. Praktika është e qëndrueshme (financiarisht, burime njerëzore, aftësia për përsëritje të qëndrueshme në kohë, por jo vetëm)	<p>Bashkia ka një përjasje të strukturuar për zhvillimin afat-gjatë të praktikës. Ka kujdes nga Kryetari dhe KB për të siguruar qëndrueshmëri dhe zhvillim të integruar e të qëndrueshëm demonstruar në planin e zhvillimit vendor, planin e veprimit lokal me synime të qarta (target).</p> <p>Vlerësohet aftësia që rekomandimet e dala nga praktika janë të qëndrueshme dhe jo të izoluara, duke treguar që edhe pas një periudhe kohore, praktika ofron të rezultate të njëjta.</p> <p>Planifikimi në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) është i siguruar, por edhe burime të tjera janë marrë në konsideratë Bashkia planifikon burimet e mjaftueshme (nga të ardhurat e veta ose donatorë të huaj, fonde nga qeveri qendrore apo kontributet komunitare), për zbatimin e praktikës dhe duke siguruar një përjasje miqësore mjedisore të kontekstit në të cilën praktika është zhvilluar.</p>	5*4

<sup>14</sup> Parimet e qeverisjes së mirë të KiE

6. Praktika ka potencial për replikim nga bashki të tjera	<p>Praktika ka potencial për t'u replikuar/riprodhuar/ose përshtatur në kontekst tjetër, "mësime të transferueshme" bazuar në kushtet sociale, ekonomike specifike ose të ngjashme.</p> <p>Praktikat e grumbullimit të mbetjeve në zonat e thella dhe të varfra, zonat turistike, praktikat e komunikimit me qytetaret për cilësinë e shërbimit, pagesat dhe penalitetet, monitorimin e shërbimit, praktikat e grumbullimit të diferencuar apo kompostimit, praktikat e transferimit të mbetjeve ndërmjet dy apo më shumë bashkive, trajtimi i mbetjeve.</p> <p>Transferimi i disa elementëve /metodave në bashki të tjera, dhe aplikimi (jo domosdoshmërisht në një shkallë më të lartë, në një tjetër kontekst, konsiderohet si sukses.</p>	5*2
7. Prezantimi	Shkrimi i praktikës në mënyrë të kuptueshme (dhe me informacion të mjaftueshëm për jurinë), vizualizimi dhe kuptueshmëria e PPT/Video, prezantimi i përmbahet kohës.	5*2
<b>Totali i pikëve</b>		<b>100</b>

### Kriteret e vlerësimit për Kategorinë 3: Administrimi dhe Menaxhimi për Mbrojtjen Civile (MC)

Nivelet e vlerësimit: 1 – shumë dobët; 2 – dobët; 3 – mjaftueshëm; 4 - mirë; 5 – shumë mire

Kritere Vlerësimi	Shtjellimi Sektorial	Pikët
1. Praktika buron nga një sistem i rregullt monitorimi (me pjesëmarrjen e stafit profesional të bashkisë, KB, institucioneve qendrore përfshirë institucionin e Prefektit, dhe aktorë të tjerë).	Praktika është pjesë e prioriteteve të bashkisë/KB dhe në përputhje me ligjin për mbrojtjen civile <sup>15</sup> dhe që lidhet me forcimin e strukturës për mbrojtjen civile, hartimin e planit të emergjencës civile, vlerësimin e riskut; roli i Këshillit Bashkiak në rast emergjence është përfshirë në rregulloren e brendshme. Ekzistojnë procese të mirë përcaktuara "shina", në të cilat praktika zbatohet.	5*2
2. Praktika demonstroi parimet e qeverisjes së mirë (përfshirja e strukturave komunitare, komunitetit të biznesit, qytetarëve dhe femrave në procese konsultimi, është respektuar transparenca dhe llogaridhënia.	<p>Praktika përputhet me bazën e rregullave normative të KB që kanë lidhje me vendimmarrjen e përbashkët.</p> <p>Rregullat dhe procedurat ekzistojnë në të gjitha proceset vendimmarrëse.</p> <p>Bashkia ka në vëmendje shtresat vulnerabël dhe komunitetet në nevojë të prekur nga situata e emergjencës; kujdes i veçantë tregohet për gratë dhe</p>	5*2

<sup>15</sup> Ligji nr 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", Ligj 152/2015 "Per Shërbimin për Mbrojtjen nga Zjari dhe Shpëtimi"

	nënat e vetme me fëmijë në një situatë të emergjencës civile.	
3. Praktika respekton kërkesat ligjore të Ligjit organik 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, ose ligjit 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”.	Bashkia ka në vëmendje kërkesat e ligji mbi hartimin e dokumentit të vlerësimit të riskut, planin e emergjencës civile (EC) të harmonizuar, trajnimin e plotësimin e stafit të strukturës së MC, plotësimin e bazës logjistike dhe materiale, bashkërendon veprimet me bashki fqinje në rast të EC. KB në vendimmarrjen e tij njuh dhe konsideron kërkesat ligjore për mbrojtjen civile. Këshilli ka vendosur standarde vendore.	5*4
4. Praktika është inovative (me inovacion kuptojmë një risi që përfshin përdorimin e teknologjisë të informacionit, por jo vetëm.	Bashkia / strukturat për MC/ KB përdorin instrumente inovative për zinxhirin e komandës dhe për të ndërvepruar me qytetarët në rast EC, si dhe për të mobilizuar me efikasitet forcat (web, instagram, Fb, aplikime në telefon) dhe instrumente të tjerë. Marrëdhëniet me ekzekutivin dhe institucione të tjera, shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë janë zhvilluar nëpërmjet instrumenteve që përbëjnë risi nga pikëpamja e efikasitetit në vendimmarrje, informim, raportim dhe minimizim të dëmeve.	5*3
5. Praktika është e qëndrueshme (financiarisht, burime njerëzore, por jo vetëm)	Praktika është e parashikuar në programin buxhetor afat-mesëm (PBA); Bashkia mbulon koston e shërbimit / të praktikës (përqindja e buxhetit të alokuar (shpenzuar për MC).  Bashkia ka planifikuar investime parandaluese bazuar në vlerësimin e riskut.  Praktika synon rritjen e kualifikimit të personelit si një nevojë për të rritur aftësinë reaguese në një situatë të EC.	5*4
6. Praktika ka potencial për replikim nga bashki të tjera	Praktika është e përballeshme nga pikëpamja financiare dhe burimeve të tjera të nevojshme. Ajo plotëson një nevojë baze me vlera dhe mundësi të gjera aplikative.	5*3
7. Prezantimi	Shkrimi i praktikës në mënyrë të kuptueshme (dhe me informacion të mjaftueshëm për jurinë), vizualizimi dhe kuptueshmëria e PPT/Video, prezantimi i përmbahet kohës.	5*2
<b>Totali i pikëve</b>		<b>100</b>

#### **Kriteret e vlerësimit për Kategorinë 4: Aktiviteti legjislativ i organit përfaqësues të Bashkisë (Këshilli Bashkiak)**

Nivelet e vlerësimit: 1– shumë dobët; 2 – dobët; 3 – mjaftueshëm; 4 - mirë; 5 – shumë mirë

Kritere Vlerësimi	Shtjellimi Sektorial	Pikët
1. Praktika buron nga një sistem i rregullt monitorimi (me pjesëmarrjen e shoqërisë civile, pushtetit vendor, institucioneve qendrore, aktorë të tjerë)	Përkon me funksionin përfaqësues dhe mbikëqyrës të këshillit ndaj ekzekutivit, por edhe vetë veprimtarisë/gjurmimit të performancës së tij (përfshirë edhe nisma të shoqërisë civile për monitorimin e këshillit të konsideruara seriozisht nga ai) përshkruar në rregulloren bazë të këshillit (aprovimi i së cilës është kusht)	5*3
2. Praktika demonstroi parimet e qeverisjes së mirë (përfshirja e qytetarëve, përfshirje e komuniteteve në nevojë, respektuar transparenca dhe llogaridhënia).	Përputhje me bazën e rregullave normative të këshillit bashkiak: rregulloren për konsultimin me publikun, rregulloren për strukturat komunitare dhe peticionin/ankimimin janë konsideruar. Këshilli ndërvepron me publikun duke i kushtuar vëmendje shtresave në nevojë dhe siguruar qasje të barabarte. Këshilli është transparent për veprimtarinë e tij ndaj publikut. Këshilli ka marrë parasysh dhe dokumentuar ankesa/kërkesa/nisma të publikut.	5*3
3. Praktika është rezultat i një funksioni vendimmarrës / mbikëqyrës i cili ka respektuar kërkesat ligjore të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore dhe Ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. KB në vendimmarrjen e tij konsideron dhe respekton standardet kombëtare të politikave kur janë të vlefshme.	Këshilli ka ndërtuar praktika në lidhje me zbatimin e udhëzimeve të dërguar nga AMVV në këtë mandat si ato që lidhen me 5 rregulloret bazë apo sekretariatit e KB.  Pjesëmarrja gjinore është promovuar në veprimtarinë e KB.  Këshilli në vendimmarrjen e tij konsideron dhe respekton standardet kombëtare të politikave kur janë të vlefshme dhe ka respektuar kërkesat ligjore të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore dhe Ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”; Këshilli ka vendosur standarde vendore.	5*3
4. Praktika është inovative (me inovacion kuptojmë një risi që përfshin përdorimin e teknologjisë të informacionit, por jo vetëm).	Këshilli përdor teknologji të informacionit (web, fb, Instagram, etj.) për të ndërvepruar me publikun dhe vetorganizuar punën e tij. Marrëdhëniet me ekzekutivin dhe institucione të tjera, shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë janë zhvilluar nëpërmjet instrumenteve që përbëjnë risi nga pikëpamja e efikasitetit në vendimmarrje, përfaqësim dhe mbikëqyrje.	5*3
5. Praktika është e qëndrueshme (financiarisht, burime njerëzore, por jo vetëm)	Praktika është e parashikuar në planin e KB dhe mbulohet nga buxheti autonom i tij, i identifikuar sipas një procesi të konsoliduar. Aktorët e përfshirë e njohin rolin e tyre dhe janë në gjendje ta përsërisin në përputhje me rregulloret dhe procedurat e KB.	5*3
6. Praktika ka potencial për replikim nga bashki të tjera	Praktika është e përballueshme nga pikëpamja financiare dhe burimeve të tjera të nevojshme. Ajo	5*3



	plotëson një nevojë baze me vlera dhe mundësi të gjera aplikative.	
7. Prezantimi	Shkrimi i praktikës në mënyrë të kuptueshme (dhe me informacion të mjaftueshëm për jurinë), vizualizimi dhe kuptueshmëria e PPT/Video, prezantimi i përmbahet kohës.	5*2
<b>Totali i pikëve</b>		100